



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KPPP.nr. 1385/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Vera Gashi Bala, në çështjen përmbartimore të kreditorit Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike Sh.a. (KESco), SH.A, me seli në Prishtinë, Bulevardi Bill Klinton, kundër debitorit Lokal S.A, adresa Regj. i përkohshëm Letnicë, Viti, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit, të ushtruar ndaj Urdhrit Përmbartimor P.nr.116/21, të datës 23.03.2021, i lejuar nga Përmbartuesi Privat, Kushtrim Musa, me seli në Gjilan, jashtë seancës, me datë 28.07.2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. APROVOHET pjesërisht prapësimi i debitorit LOKAL S.A dhe ANULOHET pjesërisht Urdhri Përmbartimor P.nr.116/21 i datës 23.03.2021, i Përmbartuesit Privat Kushtrim Musa, për pjesën e detyrimit në shumën prej 225.77 € (dyqind e njëzet e pesë euro e shtatëdhjetë e shtatë cent).
- II. REFUZOHET pjesërisht prapësimi i debitorit debitorit LOKAL S.A dhe ANULOHET pjesërisht Urdhri Përmbartimor P.nr.116/21 i datës 23.03.2021, i Përmbartuesit Privat Kushtrim Musa, sa i përket shumës prej 364.22 € (treqind e gjashtëdhjetë e katër euro e njëzet e dy cent) së bashku me kamatën ligjore sipas normës së interesit vjetor prej 8%.
- III. PËRFUNDOHET pjesërisht procedura përmbartimore e kreditorit Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike Sh.a. (KESco), ndaj debitorit LOKAL S.A, sipas urdhrit përmbartimor P.nr.116/21 i datës 23.03.2021, për shumën prej 225.77 € (dyqind e njëzet e pesë euro e shtatëdhjetë e shtatë cent).

A r s y e t i m

Përmbareuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike Sh.a., ka caktuar urdhrin P.nr.116/21 i datës 23.03.2021, duke lejuar përmbareimin në bazë të dokumentit të besueshëm - Ekstraktit të verifikuar nga librat afariste, me DGL-9018640, nga periudha kohore 31.03.2013 deri 12.03.2021, me të cilin e ka urdhëruar debitorin LOKAL S.A, që brenda afatit prej 7 ditësh pas pranimit të urdhrit, t'ia paguaj kreditorit shumën prej 589.99 €, në emër të borxhit kryesor me kamatë prej 8%, nga dita e kalimit të afatit për pagesë deri në pagesën definitive të borxhit.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, ka kundërshtuar urdhrin për lejimin e përmbareimit për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës, konstatimit të gabuar të gjendjes faktike dhe cenimit të ligjit material. Ai shtoi se dokumenti transaksionet e konsumatorit nuk mund të llogaritet si dokument i besueshëm për përmbareim, sepse të njëjtat nuk janë dokumente të besueshme në kuptim të nenit 29 të Ligjit për Procedurën Përmbareuese. Po ashtu e kundërshtoi edhe borxhin me arsyetim se i gjithi është i mbledhur sipas transaksioneve vetëm nga taksat (të cilën ka qenë i regjistruar njehsori i rrymës dhe për këtë debitori ka kërkuar të bëhet shkyçja e këtij njehsori te lokali qysh në vitin 2013, mirëpo nuk është ndërmarr asgjë nga ana e kreditorit. Po ashtu e kundërshtoi edhe borxhin për periudhën e faturimit të datës 13.04.2018 në vlerë prej 248.97 euro sepse lokali ka qenë i mbyllur. Tutje theksoi se deri në pranimin e urdhrit përmbareues nuk ka qenë në dijeni se Kreditori nuk e ka bërë shkyçjen dhe çlajmërimin e njehsorit sipas kërkesës së debitorit, po ashtu nuk ka pranuar asnjëherë faturë –vërejtje për shkyçjen apo edhe lajmërim për pagës duke e lenë që të mblidhet i gjithë ky borxh. Në fund shtoi se duke pas parasysh kohën për të cilën është propozuar përmbareim nga data 4.04.2013 deri më datën 13.02.2021. dhe se propozimi për përmbareim shihet se ka ardh deri te parashkrimi i kërkesës në kuptim të nenit 360 par. 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit për marrëdhëniet detyrimeve, ku shprehimisht thuhet , *Kërkesat të cilat parashkruhen pas 1/nië/ viti ianë kërkesat për furnizimin e energjisë elektrike...*, ku nënkuptohet se debitori as nuk e ka shfrytëzuar këtë energji elektrike për asgjë as edhe nevoja shtëpiake nga e cila na lë të kujtojmë se kreditorja ka pasur te drejtë që të kërkoj në mënyrë retroaktive borxhin e akumuluar vetëm prej 1/viti/ më parë e jo ashtu siç ka paraqitur në propozimin e saj përmbareimor, Në fund theksoi se Gjykata duhet të pranoj prapësimin e debitorit

Kreditori, në afatin e paraparë ligjor ka parashtruar përgjigje në prapësim, duke theksuar se propozimi është bërë me datë 19.03.2021, duke iu bashkuar në propozim për përmbarrim Ekstrakti nga Librat Afarist, tek Kriteri Minimal është i precizuar Borxhi Kumulativ jo i ndarë nga fatura për faturë mujore. Ka shtuar se pretendimet e kreditorit nuk qëndrojnë sepse leximi bëhet në pjesën e tretë të muajit dhe leximi i njehsorit bëhet me sondë nga aparati digjital i cili kabllon e ka vetëm 50 cm të gjatë dhe printimi i faturës bëhet në atë moment që lexohet, që nënkupton se bëhet aty ku është i vendosur njehsori dhe fatura i lihet në vend. Tutje thekson se propozimi për përmbarrim është bërë konform nenit 29, 40 përfshirë nenin 341 të LPP-së. Tutje shton se debitori asnjëherë nuk ka pasur ankese të parashtruara për kontestim të borxhit. Me datë 02.03.2020 debitori ka bërë pagesë në vlerë prej 30 euro me pagesa vullnetare të debitorit është e mjaftueshme për të manifestuar pranimin e borxhit ex-lege – shkakton ndërprerjen e parashkrimit dhe atë konform nenit 368 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve. Po ashtu kundërshton pretendimet e debitorit lidhure me parashkrimin e borxhit duke cituar neni 355 të LMD-së lidhur me kërkesat reciproke, sepse pretendimet e debitorit lidhur me parashkrimin e të bazuara në nenin 360 nuk qëndrojnë sepse debitori është i regjistruar si Konsumator Komercial. Andaj kërkoi që prapësimi të refuzohet dhe të mbetet në fuqi urdhri përmbarrimor.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim dhe kundërshtimeve të kreditorit nga përgjigjja në prapësim dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarrimore (tutje LPP), gjeti se prapësimi i debitorit është pjesërisht i pabazuar dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkak që si në vijim:

Gjykata vlerëson se në rastin konkret Ekstrakti i verifikuar nga librat afariste, në bazë të cilit është lejuar urdhri për përmbarrim, i plotëson kushtet për të qenë dokument i besueshëm dhe i përmban të gjitha elementet e kërkuara, në përputhje me nenin 29 dhe 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbarrimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, me paragrafin 3 të po të njëjtit nen, përcaktohet se: *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarrim po që se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar “*, ndërsa me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbarrim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit*

t'i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.” ndërsa sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.2 të LPP-së, ekstraktet e verifikuara nga librat afariste për pagesat e shërbimeve komunale të furnizimit me ujë, energji elektrike dhe bartjen e mbeturinave, janë përcaktuar si dokument i besueshëm sipas të cilit mund të caktohet përmbarimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Në rastin konkret gjykata vlerëson se urdhri i lejuar nga ana e përmbaruesit privat bazohet në dokumentin e besueshëm përkatësisht Ekstraktin e verifikuar nga librat afariste të kontabilitetit me ID nr.12698, e cila i përmban të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm sipas nenit 29 par. 3 të LPP-së, meqenëse në të janë treguar palët, janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturës, si dhe është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit.

Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se në rastin konkret– Ekstrakti i verifikuar nga librat afariste DGL-9018640 i plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 37 të LPP-së, për zbatimin e përmbarimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që e njëjta është e dorëzuar në kopje të verifikuar.

Duke vlerësuar pretendimet e debitorit lidhur me afatet e parashkrimit, gjykata pas vlerësimit të ekstraktit nga librat afarist për faturat e përfshira në ekstrakt dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 355 paragrafi 1, dhe paragrafi 2 të LMD-së (Ligji Nr.04/L-077), ka arritur në përfundim se kërkesa e kreditorit pjesërisht është parashkruar.

Me dispozitën e nenit 355 paragrafi 1 të LMD-së përcaktohet se *“1. Kërkesat reciproke nga kontratat komerciale si dhe kërkesat e shpërblimit të shpenzimeve të bëra lidhur me këto kontrata, parashkruhen për tri (3) vite. Ndërsa me paragrafin 2 të të njëjtit nen përcaktohet se: “Parashkrimi rrjedh veç e veç për çdo dërgim të mallit, pune ose shërbimi të kryer”.*

Në rastin konkret duke llogaritur afatin e arritjes për pagesë të secilës kërkesë veç e veç, rezulton se kërkesat e kreditorit për faturat nga data 31.03.2013 deri me datën 14.03.2018 në shumën prej 225.77 €, janë parashkruar sipas nenit 355 të LMD, pasi që propozimi i kreditorit për përmbarim është paraqitur me datë 22.03.2021, ndërsa për secilën nga kërkesat e kreditorit sipas faturave të cekura më lart kanë kaluar më tepër se 3 (tri) vite nga koha e maturimit/arritjes për pagesë.

Ndërsa sa i përket borxhit sipas faturave për periudhën kohore 12.04.2017 gjerë me datë 12.03.2017, gjykata gjeti se i njëjti është i bazuar dhe nuk ka vjetërsim-parashkrim të borxhit të kreditorit në raport me debitorin për këtë periudhë kohore, referuar nenit 355 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (Ligji Nr.04/L-077), në të cilën parashihet afati 3 (tre) vjeçar i parashkrimit për kërkesat reciproke nga kontratat komerciale si dhe kërkesat e shpërblimit të shpenzimeve lidhur me këto kontrata, ndërsa parashkrimi rrjedh veç e veç për çdo dërgim të mallit, pune ose shërbimi të kryer, e që në rastin konkret për secilën nga kërkesat sipas faturave për periudhën prej 13.04.2018 gjerë me datë 12.03.2021, nuk kemi kalim të afatit të parashkrimit, për faktin se kreditori me datë 22.03.2012 ka ushtruar propozim për përmbarim, me çka ka shkaktuar ndërprerjen e rrjedhjes së afatit të parashkrimit konform nenit 369 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve.

Gjykata vlerësoi edhe pretendimet e kreditorit se debitori me pagesat e realizuara ka bërë pohimin e borxhit dhe se kemi ndërprerje të parashkrimit dhe gjeti se të njëjtat nuk gjejnë mbështetje ligjore, për faktin se me dispozitat e nenit 368 par.1 të LMD-së parashihet se *Parashkrimi ndërpritet kur debitori e pranon borxhin*, ndërsa nenin 368 par.2 parashihet se *“Pranimi i borxhit mund të bëhet jo vetëm me deklaratën e kreditorit, veçse edhe në mënyrë të tërthortë, sikurse janë pagesa e këstit, pagesa e kamatës, dhënia e sigurimit”*, andaj në rastin konkret pagesat e realizuara nga ana e debitorit nuk përbëjnë ndërprerje të parashkrimit, për faktin se nuk kemi të bëjmë me pagesa të këstit

Prandaj, bazuar në të lartcekurat, Gjykata gjeti se kërkesa e kreditorit për faturat nga data 31.03.2013 deri me datën 12.03.2017, është parashkruar, andaj pjesërisht e aprovoi si të bazuar prapësimin e debitorit dhe atë për shumën prej 225.77 €, e anuloi urdhrin për përmbarim P.nr.116/21 të datës 23.03.2021, të Përmbaruesit Privat Kushtim Musa, dhe vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Meqenëse në rastin konkret është vërtetuar se debitori ka mbetur borxh ndaj kreditorit për shumën e cekur në pikën II të dispozitivit të këtij aktvendimi, gjykata lidhur me këtë pjesë të kërkesës së kreditorit e refuzoi prapësimin e debitorit dhe e la në fuqi urdhrin për lejimin e përmbarimit P.nr.116/21 të datës 23.03.2021, të Përmbaruesit Privat Kushtim Musa, për shumën prej 364.22 €, pasi që vlerësoi se borxhi për këtë shumë nuk është parashkruar.

Gjykata vendosi që të mbetet në fuqi urdhri i përmbaruesit privat edhe në pjesën lidhur me kamatën prej 8%, dhe atë duke u bazuar në nenin 382 të LMD-së me të cilin përcaktohet se: *“Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën”*, për faktin se debitori ka rënë në vonesë për përmbushjen e detyrimit në shumën prej 364.22 €, me çka rezulton se kreditorit i takon e drejta për kamatëvonesë lidhur me këtë shumë që nga momenti kur faturat janë bërë të arritshme për pagesë e deri në pagesën definitive.

Nisur nga fakti se në rastin konkret gjykata ka aprovuar pjesërisht prapësimin e debitorit duke u bazuar në nenin 12 paragrafin 2 të Ligjit Nr.05/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, me të cilin përcaktohet se: *“Në rast se e aprovon prapësimin, gjykata varësisht nga rrethanat e rastit e përfundon përmbarimin në tërësi ose pjesërisht dhe i anulon veprimet e kryera”*, gjykata vendosi si në pikën III të dispozitivit, dhe e përfundoi pjesërisht procedurën e përmbarimit.

Gjykata në kuptim të nenit 71 dhe 73 të LPP-së, nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore si dhe nenit 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1385/22, datë 17.07.2023

Gjyqtarja

Vera Gashi Bala

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.